

LIGJ
Nr. 17/2014

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 8580 DATË 17.2.2000, “PËR PARTITË POLITIKE”,
TË NDRYSHUAR**

(Ndryshuar me ligjin nr. 125/2014, datë 25.9.2014)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar, bëhet shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 19, shkronja “b”, rreshti i dytë, pas fjalëve “partive parlamentare” shtohen fjalët “dhe partive që kanë marrë mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare”.

Neni 1/1

Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji, për vitin buxhetor 2014, shtrihen vetëm për periudhën nga hyrja në fuqi e tij deri në fund të vitit.

Përfundimisht për vitin 2014, Ministria e Financave, në bashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, përcakton masën e fondit publik që përfiton çdo parti politike, në formën e ndihmës financiare vjetore, në përputhje me këtë ligj.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.2.2014

Shpallur me dekretin nr. 8512, datë 6.3.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani